



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks : 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



Data: 04 Janar 2017

Njoftim

Buxhet më të lartë për metodat e reja, barna dhe rritjen e vëllimit të shërbimeve shëndetësore

Fondi për Sigurim Shëndetësor i Republikës së Maqedonisë vitin 2017 do t'a fillojë me një buxhet historikisht më të lartë në vlerë prej 26 miliardë e 947 milion denarë. Ky buxhet është për 1 miliard e 370 milion denarë më i lartë në krahasim me vitin e kaluar ose 5,4% ndërsa në krahasim me vitet e 2000-ta kur është themeluar Fondi me buxhet prej 12 miliard e 500 milion denarë, rritja është dyfishuar respektivisht është rritur për 27 miliard denarë.

Fondi ka vazhduar me praktikën e shpërndarjes së buxhetit në mënyrë të drejtë dhe transparente. Në dy muajt e fund të vitit 2016, Fondi negocioi me të gjitha institucionet e sistemit shëndetësor dhe në mënyrë metodologjike ka bërë shpërndarjen e buxhetit tek të gjitha Institucionet shëndetësore publike dhe private që kanë marrëveshje me Fondin.

Shpërndarja e buxhetit është bazuar në këto parametra:

1. Analizat se si është realizuar buxheti i vitit të kaluar 2016;
2. Të dhënat e Institucioneve shëndetësore nga negociatat dhe marrëveshjet e realizuara në fundvit;
3. Plani për llojin dhe vëllimin e shërbimeve shëndetësore egzistuese, metodave të reja si dhe shërbimeve të reja shëndetësore që i propozojnë vetë Institucionet shëndetësore publike;
4. Qëndrueshmëria e institucioneve shëndetësore publike

Krahasimi i përgjithshëm i shpërndarjes së buxhetit për vitin 2017 është si në vijim:

SHPENZIMET	Mjetet për vitin 2017 (të shprehura në 000 denarë)
Shërbimet shëndetësore	23.477.527
Kompenzimet e pushimit të lindjes dhe pushimit mjekësor	2.900.000
Shpenzimet administrative të FSSHM-së	569.527
GJITHSEJ	26.947.054



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks : 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



Ndarrja e buxhetit për vitin 2017 e shprehur në përqindje, qëndron si në vijim: Institucionet shëndetësore publike marrin 53,14% nga buxheti i Fondit, Institucionet shëndetësore private marrin 30,57%, kompensimet e pushimit të lindjes dhe pushimit mjekësor marrin 10,76%, paisjet ortopedike 1,67%, mjekimet jashta shtetit 1,48%, shpenzimet administrative për funksionimin e Fondit (investimet kapitale dhe softverike) 2,11%.

Në kuadër të rritjes së mjeteve prej 1 miliard e 370 milion denarë në buxhetin fillestar të vitit 2016, 1 miliard e 50 milion denarë përfaqësojnë rritjen e mjeteve për shërbimet shëndetësore ndërsa 325 milion denarë përfaqësojnë rritjen e mjeteve për kompensimet e pushimit të lindjes dhe pushimit mjekësor. Edhe këtë vit pritet të vazhdojë trendi i njejtë rritës sa i përket pushimit të lindjes. Tek pagesat e pushimit të lindjes ndikon edhe rritja e kohëzgjatjes së pagesës së pushimit të lindjes prej 12 muaj në 15 muaj, për nënat që lindin bineqë.

Sa u përket shërbimeve shëndetësore, krahasuar me vitin 2016, rritja më e madhe e mjeteve u dedikohet Institucioneve shëndetësore publike edhe atë 566 milion denarë ose rritje prej 4,1% (prej të cilave, 114 milion denarë janë rritur në fund të vitit 2016), tek Institucionet shëndetësore private rritja është për 160 milion denarë shkaku i rritjes së vlerës së kapitacionit tek mjekët amë, për barnat që jepen me recetë rritja është 80 milion denarë ndërsa janë të parapara edhe 200 milion denarë shtesë dhe për dializë janë të parapara 50 milion denarë shtesë.

Në dy vitet e fundit buxheti i Institucioneve shëndetësore publike është rritur pothuajse 1 miliard e 500 milion denarë prej të cilave, në vitin 2016 kemi rritje të buxhetit për 973 milion denarë ndërsa për vitin 2017 kemi siguruar edhe 458 milion denarë shtesë. Buxheti prej 1 miliard e 370 milion denarë (919 milion denarë) destinohet për një sasi më të madhe të barnave që jepen me recetë ashtu që disponueshmëria e tyre të jetë më e madhe nëpër barnatoret që kanë marrëveshje me Fondin, për rritjen e vlerës së kapitacionit për mjekët amë dhe stomatologët amë, për kompensimet e pushimit të lindjes dhe pushimit mjekësor, për in-vitro si dhe për mjekimet jashta shtetit.

Me rritjen e mjeteve prej 458 milion denarë të Insitucioneve shëndetësore publike për vitin 2017, Fondi e përkrah dhe e nxit shëndetin publik. Rritjen e këtyre mjeteve destinohet për këto segmente:

- Shërbime të rreja shëndetësore duke shfrytëzuar metoda të rreja për mjekim;
- Rritjen e llojit dhe vëllimit të shërbimeve shëndetësore egzistuese;
- Qëndrueshmëri financiare institucioneve shëndetësore publike që kanë nevojë financiare për të funksionuar në mënyrë normale;



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks : 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



- Punësime te reja të mjekëve specialist (transformimet dhe tërheqja nga sektori shëndetësor privat);
- Rritja e pagave për një kategori të caktuar të të punësuarve shëndetësor.

Rritja e buxhetit të Institucioneve shëndetësore publike është stimuluese dhe motivuese me qëllim që të ofrojnë vëllim më të madh të shërbimeve shëndetësore me kualitet më të mirë. Rritja e mjeteve është kushtëzuar me rritjen e numrit të intervenimeve kirurgjikale tek spitalet klinike dhe spitalet e përgjithshme, me qëllim që të zvogëlohet udhëzimi i pacientëve drejt klinikave të Shkupit. Klinikat janë të kushtëzuara të ofrojnë shërbime shëndetësore të reja, metoda të reja të punës si dhe të rrisin llojin dhe vëllimin e shërbimeve shëndetësore egzistuese.

Në vijim do të theksojmë disa institucione shëndetësore publike që janë pjesë e kësaj rritjes:

1. Klinika Universitare për radioterapi dhe onkologji me buxhet prej 608,4 milion denarë ose rritje prej 32 milion denarëve nga viti 2016. Rritja e mjeteve dedikohet për t'u furnizuar me terapi më bashkëkohore dhe me barna të reja nëpërmjet buxhetit kushtëzues i cili do të përcaktohet deri në fund të këtij muaji.
2. Klinika Universitare për hematologji me 275,4 milion denarë ose rritje prej 28 milion denarëve nga viti 2016. Rritja e mjeteve dedikohet për t'u furnizuar me barnave të reja nëpërmjet buxhetit kushtëzues i cili do të përcaktohet deri në fund të këtij muaji.
3. Klinika Universitare për kardiokirurgji shtetërore me 79 milion denarë ose rritje prej 20 milion denarëve nga viti 2016. Rritja e mjeteve dedikohet për rritjen e vëllimit të shërbimeve shëndetësore respektivisht numrit të pacientëve që planifikohen përgjatë vitit 2017.
4. Klinika Universitare për kardiologji me 360,4 milion denarë ose rritje prej 18 milion denarëve nga viti 2016. Rritja e mjeteve dedikohet për metodat e reja që do të financohen përmes buxhetit kushtëzues për pacinetët që nuk mund t'i nënshtrohen operacioneve kardiokirurgjikale por do të shërbehen me intervenime shëndetësore që e zëvendësojnë operimin (TAVI, TEVAR, EVAR) si dhe ablacion për fibrilacion atrial.
5. Klinika Universitare për sëmundje të syve me 104,4 milion denarë ose rritje prej 15 milion denarëve nga viti 2016. Rritja e mjeteve dedikohet për buxhetin kushtëzues për metoda të reja, transplantin e kornesë së syrit dhe kirurgjisë së syrit.



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks : 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



6. Spitali i përgjithshëm i qytetit '8 Shtatori' me 869,9 milion denarë ose rritje prej 15 milion denarëve nga viti 2016. Rritja e mjeteve dedikohet për metodat e reja të parapara gjatë negociatave dhe marrëveshjeve të realizuara me Fondin.
7. Klinika Universitare për sëmundje infektive dhe gjendje febrile me 179,7 milion denarë ose rritje prej 10 milion denarëve nga viti 2016. Rritja e mjeteve dedikohet për furnizimin e terapisë bashkëkohore për Hepatit C.
8. Instituti për sëmundje të mushkërive tek fëmijët 'Kozle' me 125,9 milion denarë ose rritje prej 10 milion denarëve nga viti 2016. Rritja e mjeteve dedikohet për furnizimin e paisjeve ortopedike bashkëkohore për t'a pranuar terapinë fëmijët me fibrozë cistike, si dhe për skringjet neonatale për zbulimin e sëmundjeve të fshehta tek foshnjat.
9. Klinika Universitare për gjinekologji dhe akusherit me 418,9 milion denarë ose rritje prej 10 milion denarëve nga viti 2016. Rritja e mjeteve dedikohet për rritjen e numrit të lindjeve dhe faturës që e tejkalon buxhetin e përcaktuar nga Fondi.
10. Spitali special për gjinekologji dhe akusherit 'Nënë Tereza' në Çair me 139,1 milion denarë ose rritje prej 10 milion denarëve nga viti 2016. Rritja e mjeteve dedikohet për rritjen e numrit të pacientëve.
11. Spitali Klinik Tetovë me 470,7 milion denarë, Manastir me 611,2 milion denarë dhe Shtip me 348,1 milion denarë ose rritje prej 10 milion denarëve për secilin insitucion. Rritja e mjeteve dedikohet për rritjen e numrit të intervenimeve kirurgjikale respektivisht operacioneve të verdhëzës, bruhit dhe zorrës së verbër.

Fondi për sigurim shëndetësor mbetet i qëndrueshëm me përpjekjet për t'a avansuar sferën e shëndetësisë në përgjithësi si dhe me përmirësimin e të drejtës të të siguarve që rrjedh nga Ligji për sigurim shëndetësor.